

VENDIM
Nr. 356, datë 19.4.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIM URBAN NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË”, FAZA I ¹**

(Ndryshuar me VKM nr. 95, datë 27.2.2019)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë”, faza I. 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 55 686 002 (pesëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 55 686 002 (pesëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dy) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

¹ Vendimi nr. 356, datë 19.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 26 prill 2017.
VKM nr. 95, datë 27.2.2019 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 26, datë 5 mars 2019.

LISTA E PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI: “RIKUALIFIKIM URBAN, ME VENDNDODHJE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË” FAZA I

(Shtuar numri rendor 18 (tetëmbëdhjetë) me VKM nr. 95, datë 27.2.2019)

Çmimi i truallit sipas VKM nr. 89/2016

Çmimi për banesat konform VKM nr.138, datë 23.3.2000 konfirmuar sipas ZVRPP

Çmimi për njësitë e shërbimit, konform VKM nr.138, datë 23.3.2000 sipas çmimeve të EKB

Nr.	Zk.	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sip. trualli	Sip. ndërtimi	Çmimi i truallit leke/m ²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe e ndërtesës	Shënime
1	8605	6/272	Vlorë	Bp. Gunbardhi, Velaj, Tartari	1778	0	8,300.00	14,757,400.00		14,757,400.00	Plotësim dokumentacioni
2	8605	6/240	Vlorë	Bp Agalliu (Fitnete, Afrim,Dashamir,Marjana,Teferi Agalliu)	1000.5	0	8,300.00	8,304,150.00		8,304,150.00	Plotësim dokumentacioni
3	8605	6/241	Vlorë	Bp. Xhemali (Hajri Xhemali, Avni Xhemali,Zaide Xhemali, Agim Xhemali	432	0	8,300.00	3,585,600.00		3,585,600.00	Plotësim dokumentacioni
4	8605	6/242	Vlorë	Bp. Xhemali (Hajri Xhemali, Avni Xhemali,Zaide Xhemali, Agim Xhemali	572	0	8,300.00	4,747,600.00		4,747,600.00	Plotësim dokumentacioni
5	8605	6/66-nd/3	Vlorë	Agim Xhemali	0	99	-	-	2,442,758.00	2,442,758.00	Plotësim dokumentacioni
6	8605	6/169	Vlorë	Bp Agalliu	36	0	8,300.00	298,800.00		298,800.00	Plotësim dokumentacioni
7	8605	6/159	Vlorë	Bp Agalliu	113.5	0	8,300.00	942,050.00		942,050.00	Plotësim dokumentacioni
8	8605	11./92	Vlorë	Bp.Sorra,Agalliu,Topallaj,Velaj, Barakaj,Haxhi,Zinxhiria ,Cobani; Graceni, Qemali	1329	0	8,300.00	11,030,700.00		11,030,700.00	Plotësim dokumentacioni

9	8605	11/176	Vlorë	Bp.Agalliu	61	0	8,300.00	506,300.00		506,300.00	Plotësim dokumentacioni
10	8605	11/84	Vlorë	Bp.Lulja	350	0	8,300.00	2,905,000.00		2,905,000.00	Plotësim dokumentacioni
11	8605	11/182	Vlorë	Bp.Kokona, Bino, Celaj, Polloj, Balili	31	0	8,300.00	257,300.00		257,300.00	Plotësim dokumentacioni
12	8605	11/139	Vlorë	Bp.Agalliu	7.3	0	8,300.00	60,590.00		60,590.00	Plotësim dokumentacioni
13	8602	2/16-Nd	Vlorë	Porina Mucaj	29.5	29.5	10,903.00	321638.5	1,385,409.00	1,707,047.50	Plotësim dokumentacioni
14	8602	4/21	Vlorë	Bp.Bojaxhi	25	0	10,903.00	272,575.00		272,575.00	Plotësim dokumentacioni
15	8602	4/9	Vlorë	Bp.Bojaxhi	75	0	10,903.00	817,725.00		817,725.00	Plotësim dokumentacioni
16	8602	4/2- Të 4/2-D	Vlorë	David Dema	4	4	10,903.00	43,612.00	180,127.00	223,739.00	Plotësim dokumentacioni
17	8602	2/134/1	Vlorë	Sabit Rakipi	70.2	49.6	10,903.00	765,390.60	2,061,277.00	2,826,667.60	Plotësim dokumentacioni
18	8602	2/125	Vlorë	Bashkëpronarët Çakërri, Koka, Kreshpaj dhe Aliçoti	362.5	-	10,903	3,952,337.50	-	3,952,337.50	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit "trull".

Shuma lekë

59,638,339.6